



Pranuar / Dërruar Punëpunë/Prodato Received / Delivered	07.08	2023	3	viti god year
Organ /Ispesa Organ /Jednoca Org alluit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shënime Pajlog Appendix	Sasia Kolicina Quantity	
SKIPM SHICK	55641	2023	115	



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.880/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës – Kolegji për shqyrtimin e ankesave nga: Eshref Shabani-kryetar Arben Mehmeti dhe Malsore Gashi – Bajraktari anëtarë, me Rushit Kajtazi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën A.nr. 880/2023, të datës 23.06.2023, të parashtruar nga ankuesja , me përfaqësim me adresë rruga “Dëshmorët e Kombit”, Ulpianë C-2 2/6 nga Komuna e Prishtinës, kundër masës disiplinore vërejtje të datës 29.05.2023 të shqiptuar nga Udhëheqësja e Qendrës për Strehimin, Mbrojtën dhe Rehabilitimin e Viktimave të Trafikimit me Qenie Njerëzore në Ministrinë e Punëve të Brendshme, në çështjen juridike “masë disiplinore”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1.1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe në pajtim me Rregulloren 02/2018, për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim me datë 07.08.2023, mori këtë:

V E N D I M

I. Refuzohet si e pabazuar ankesa A.nr. 880/2023, të datës 23.06.2023, të parashtruar nga ankuesja

II. Mbetet në fuqi vërejtja e datës 29.05.2023, e shqiptuar nga Udhëheqësja e Qendrës për Strehimin, Mbrojtën dhe Rehabilitimin e Viktimave të Trafikimit me Qenie Njerëzore në Ministrinë e Punëve të Brendshme.

A r s y e t i m

Ankuesja me datë 23.06.2023, me numër protokolli 4890/2023, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me pretendimet ankimore së Udhëheqësja e Qendrës për Strehimin, Mbrojtën dhe Rehabilitimin e Viktimave të Trafikimit me Qenie Njerëzore i ka shqipëruar vërejtje me shkrim për mes e-mailit të datës 29.05.2023.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, me datë 03.07.2023, për mes e-mailit e ka dërguar kërkesën për përgjigje në anekse tek Ministria e Punëve të Brendshme ndërsa me datën 10.07.2023 me numër protokoll 880/2023, Këshilli ka pranuar përgjigje në ankesë nga Ministria e Punëve të Brendshme.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka administruar këto prova: Ankesën A nr. 880/2023 e datës 23.06.2023, me numër protokoll 4890/2023, drejtuar Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Dëshmi mjekësorë e datës 03.02.2023; Autorizimi i datës 21.06.2023; Akt emërimi me numër protokoll 23, i datës 26.01.2023; vërejtja e datës 29.06.2023, për mes e-mailit; Provë 1 A, 1 B dhe 1 C; shkresë e datës 31.05.2023; E- maili i datës 29.05.2023; E- maili i datës 01.02.2023; E- maili i datës 06.02.2023; Provë e datës 03.02.2023; E- maili i datës 08.02.2023; Ekstra procesverbali i datës 27.04.2023; Formulari i Vlerësimit për Rezultateve në Punë i datës 10.03.2023; provë shtesë e datës 11.07.2023; Përgjigjeje në ankesë e datës 11.07.2023, me numër protokoll 880/2023.

Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave, pas shqyrtimit të të gjitha shkresave të lëndës të parashtruara nga palët, ka konstatuar se ankesa e ankueses, *është e pabazuar, sepse:*

Udhëheqësja e Qendrës për Strehimin, Mbrojtën dhe Rehabilitimin e Viktimave të Trafikimit me Qenie Njerëzore në Ministrinë e Punëve të Brendshme më datë 29.05.2023 përmes emailit ankueses i ka shqipëruar masën disiplinore *vërejte*, me arsyetimin se *ankuesja në të njëjtën ditë (29.05.2023), ka njoftuar mbikëqyrësen e drejtpërdrejte se gjatë bisedës që ka pasur gjatë orarit të punës me viktimën (11 vjeçaren), ka thënë viktimës se pse nuk po vepron me akteret tjera sikurse me neve, si shembull: pse nuk qani para tyre tu kanë shkel të drejtat tua, po ashtu në masën disiplinore theksohet se arsyet e shqiptimit të kësaj mase është se disa herë është kërkuar që të kihet kujdes të shtuar lidhur me trajtimin e rasteve të strehuara dhe se forma e këtij komunikimi me rastet e strehuara është rreptësisht e ndaluar.*

Ankuesja në ankesë e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës kundër masës disiplinore të shqiptuar pretendon se kjo masë është shqiptuar pa argumentin të gjendjes faktike dhe pa argumentim të provave materiale sepse e njëjta është e shqiptuar në kundërshtim me dispozitat e nenit 48 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Kolegji i Këshillit, gjatë shqyrtimit të pretendimeve ankimore të ankueses si dhe referuar provave materiale të lëndës, konstaton se masa disiplinore vërejte e datës 29.05.2023 e shqiptuar nga Udhëheqësja e Qendrës për Strehimin, Mbrojtën dhe Rehabilitimin e Viktimave të Trafikimit me Qenie Njerëzore ndaj ankueses përmban të gjitha elementet respektivisht e njëjtë përmban arsyetimin dhe po ashtu edhe udhëzimin juridike, konkretisht me Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë dhe Rregulloren (QRK) Nr. 11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publikë nuk është specifikuar që për shqiptimin e masës së lehtë disiplinore në këtë rast Vërejtje duhet të nxjerrët vendim, ngase sipas nenit 10 paragrafi 6 të Rregullores (QRK) Nr. 11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publikë, është përcaktuar se: *“6. Për procedurën dhe vendimmarrjen e komisionit disiplinor, zbatohen dispozitat e Ligjit për procedurën e përgjithshme administrative”, mbi këtë*

bazë Kolegji, konstaton se vetëm në rastet kur Komisioni Disiplinor vendosje zbatohet dispozitat e Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Nisur nga kjo nenit 46 paragrafi 2 i Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, përcakton se: *"2. Forma e shkruar përmbushet edhe nga një dokument elektronik në pajtim me ligjin e posaçëm që rregullon dokumentin elektronik"*, si rrjedhojë masa disiplinore e shqiptuar përmes emailit plotëson kushtet ligjore të përcaktuara si më lartë dhe ato të përcaktuara me nenin 11, 12 dhe 13 të Ligjit Nr. 04/L-184 për Administrimin e Punës në Zyrë, si rezultat i kësaj Kolegji i Këshillit, thekson se ky njoftim për masë është bërë edhe në pajtim me nenin 109 paragrafi 2 të Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Gjatë shqyrtimit të ligjshmërisë së masës disiplinore të shqiptuar ndaj ankueses, Kolegji i Këshillit, në bazë të provave materiale të lëndës, konstaton se sipas fletores së shënimeve të Qendrës për Strehimin, Mbrojtën dhe Rehabilitimin e Viktimave të Trafikimit me Qenie Njerëzore evidentohet fakti se ky shkrim është nënshkruar nga tri zyrtare e që theksohet se *Më datë 29.05.2023 VT-V.M është shqetësuar se po i shkelen të drejtat e saj. Një gjë e tillë iu është thënë nga stafi i ndërrimit të natës të datës 28.05.2023, ndërsa vetë viktimja ka shkruar se Pram teta Flor um ka thanë që pom shkelen të drejtat që pi 15 korrikut janë pushimet deri në shtator dhe unë u bërë meka për qëndrimin tim të gjatë në këtë strehimore.* Marr parasysh provat e lëndës, evidentohet fakti që pas ankesës së viktimës, nëpunëset e kësaj qendre V.I dhe M.B në takim me zyrtarët e Policisë së Kosovës, ndërsa nëpunësja V.I e cila është edhe menaxhere e rastit për viktimë V.M, e njëjta deklaroi se *në një vizite nga PK/DHTQNJ që ishin në Qendrës më datë 31.05.2023 i njoftova lidhur me këtë ankesë, ku potencon që drejtoresha vetëm ka marr masa e menjëhershme duke e njoftuar edhe menaxhmentin e MPB.*

Kolegji i Këshillit, konstaton se mbikëqyrësja e drejtpërdrejtë e ankueses më datë 01.02.2023 ka informuar nëpunëset e qendrës mesin e tyre edhe ankuesen se është njoftuar nga Policia e Kosovës se njëra nga zyrtarët e qendrës ka kërkuar nga oficeret policor që të mos evidentohet sipas orarit në listën e hyrje-daljeve dhe në këtë rast ka kërkuar nga zyrtarët e Qendrës që të jenë të vetëdijshme që gjërat e tilla mos të ndodhin, ndërsa Shefi i Sektorit të operativës në Stacionin Policor në Lipjan përmes emailit të datës 08.02.2023 njofton mbikëqyrësen e drejtpërdrejtë të ankueses se *...njëra nga punëtoret e Qendrës së juaj, F.I kishte kërkuar nga zyrtarët policor t' e shikon listën e evidentimit të hyrjeve-daljeve të cilët policët e kishin lejuar t' e shikuar mirëpo e njëjta kishte kërkuar që të e merr listë e evidentimit me arsye se po i duhet të fotokopjojë dhe më pas të kthej prapë... mirëpo zyrtarët policor nuk e kishin lejuar të merr dhe të bëjë fotokopje... kemi pasur ankesa të tjera nga zyrtarët policor që një punëtores (NN) e qendrës në fjalë, ishte vonuar për t'u paraqitur me kohë në punë dhe e njëjta (NN) kishte kërkuar që të evidentojnë se kine kishte ardhur me kohë në punë. Gjatë bisedës që kam pasur me zyrtarët policor pretendohet se mund të jetë F.I. po ashtu nëse i referohemi vlerësimit të rezultateve në punë për ankuesen për vitin 2022 të bërë nga mbikëqyrësja e drejtpërdrejtë më datë 10.03.2023 e të nënshkruar edhe nga ankuesja po me këtë datë, Kolegji i Këshillit, konstaton se sipas këtij vlerësimi tek komentet e vlerësuesit theksohet se *nuk është sa duhet e përgjegjshme me ardhjen gjatë orarit, e njëjta nganjëherë ngrit shqetësime të pa nevojshme për mundësin e mbulimit të orarit duke iu referuara orareve të kolegeve tjera. Znj. Smajli ka pranuar gjatë vitit disa here rekomandime dhe udhëzime nga unë për mënyrë e sjelljes së saj ndaj stafit të qendrës dhe ndaj akterëve të ndryshë, me të cilat Qendra ka kontakt. Përformanca e saj në këtë drejtim duhet përmirësuar, si rezultat i kësaj nëpunësve të Qendrës i është ripërsëritur kërkesa për respektimin e rregullave dhe obligimeve që lidhen me**

funksionimin e qendrës e kjo evidentohet sipas procesverbalit të darës 27.04.2023 të mbajtur mes Udhëheqësja e Qendrës për Strehimin, Mbrojtën dhe Rehabilitimin e Viktimave të Trafikimit me Qenie Njerëzore dhe zyrtareve të kësaj qendre i cili procesverbal evidentohet i nënshkruar nga të gjithë të pranishmit.

Nga theksimet si më lartë, ankuesja në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës nuk ka mund të argumentoj me asnjë provë që pretendimet e mbikëqyrëse së saj të drejtpërdrejtë me rastin e shqiptimit të masës disiplinore janë pretendimet të paqëndrueshme, përkundër kësaj nga provat e lëndës të administruar si më lartë argumentohet fakti se ankuesja nuk ka përfillur kërkesat për çasje etike në raport me të strehuarën po ashtu edhe në raport me të tjerët e në këtë rast me zyrtarët policor e veprime këto që kanë të bëjnë me përgjegjësitë e saj në raport me përshkrimin e detyrave të punës, si rezultat i kësaj ankuesja me veprimet e saj ka vepruar në kundërshtim me nenin 25 paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, i cili përcakton se: *"1. Zyrtari publik detyrohet të respektojë Kushtetutën dhe ligjin dhe të mbrojë interesin e shtetit dhe të drejtat dhe liritë e njeriut. 2. Zyrtari publik ushtron detyrat e tij me profesionalizëm, paanësi, pa diskriminim, në kohë, pa interes personal dhe në përputhje me ligjin dhe kodin e etikës"*, ngase zyrtari publik gjatë punës së tij duhet të jetë i përgjegjshëm dhe gjatë ushtrimit të detyrës mban përgjegjësi të plotë sipas ligjit, për çdo veprim apo mosveprim të tij siç parashihet me nenin 28 të këtij ligji, po ashtu nga veprimet e ankueses, Kolegji konstaton se e njëjta ka bërë shkelje disiplinore të përcaktuara me nenin 46 paragrafi 4 nën paragrafi 4.2, 4.3 dhe 4.4 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, andaj edhe janë plotësuar të gjitha elementet e përgjegjësisë disiplinore të parapara me nenin 45 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, i cili ka përcaktuar se: *"1. Përgjegjësia disiplinore është moszbatimi apo zbatim jo i duhur i detyrave të punës dhe detyrimeve të tjera ligjore, që përmban elementet si në vijim: 1.1. "ekzistimin e veprimit të paligjshëm apo mosveprimit;" 1.2. kryerjen e veprimit me faj apo mosveprimit; 1.3. ndodhja e pasojës 1.4. ndodhja e dëmit; dhe 1.5. lidhjen shkakësore ndërmjet veprimit të kryer dhe pasojës/dëmit"*.

Për rrjedhojë, Kolegji i Këshillit, konstaton se mbikëqyrësja e drejtpërdrejtë e ankueses më rastin e shqiptimit të masës disiplinore të datës 29.05.2023 ndaj ankueses, ka arritur të bëjë kualifikimin e drejtë të shkeljes disiplinore dhe duke marr për bazë elementet e përgjegjësisë disiplinore, këtë masë e ka shqiptuar në pajtim me nenin 45, nenin 46 paragrafi 4 nën paragrafi 4.2, 4.3 dhe 4.4, nenin 47 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1, nenin 48 paragrafi 1 dhe 2, nenin 50 paragrafi 1, 2 dhe 4 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë dhe dispozitave të Rregullores (QRK) Nr. 11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publikë, kështu që të gjitha pretendimet ankimore të ankueses janë të pabazuara.

Bazuar në këto rrethana, Kolegji për shqyrtimin e ankesës, pas analizimit dhe vlerësimit të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda, A.nr. 880/2023, datë 07.08.2023

Rushit KAJTAZI

Procesmbajtës

Eshref SHABANI

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Shoqërisë së Avokateve ;
- Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore në Ministria e Punëve të Brendshme;
- Arkivit të KPMSHCK-së,